



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

NJOFTIM PËR MEDIA

Ditën e mërkurë, datë 02.09.2026, në mjediset e Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), u zhvillua mbledhja e radhës së AMA-s, ku morën pjesë anëtarët e mëposhtëm:

Armela	KRASNIQI	Kryetar
Desada	METAJ	Zëvendëskryetar
Aurela	BICJA	Anëtar
Besian	ZOGAJ	Anëtar
Gjergji	HAMITI	Anëtar
Jetmir	HALILAJ	Anëtar
Joana	ALLUSHI	Anëtar

AMA, pas shqyrtimit të çështjeve të rendit të ditës vendosi:

1. Rinovimin e autorizimit të shoqërisë “Sabatel” sh.p.k., për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Digital”, për një periudhë 5 (pesë) vjeçare. **(Vendim nr. 97, datë 02.09.2026)**
2. Refuzimin e ankimit administrativ dhe lënien në fuqi të sanksionit gjobë nr. 31, datë 13.07.2026, të vendosur ndaj shoqërisë “G2 Media” sh.p.k., për subjektin audioviziv “A2”. **(Vendim nr. 98, datë 02.09.2026)**
3. Refuzimin e ankimit administrativ dhe lënien në fuqi të sanksionit gjobë nr. 32, datë 13.07.2026, të vendosur ndaj shoqërisë “Johaniteri” sh.p.k., për subjektin audioviziv “MCN TV”. **(Vendim nr. 99 datë 02.09.2026)**
4. Miratimin e afatit përfundimtar të shlyerjes me këste të detyrimeve financiare për vitin 2026 për shoqëritë “Digitalb” sh.a, “ADTN” sh.a. dhe “Top Channel” sh.a. si dhe rrëzimin e kërkesës për shtyrje të afatit deri në muajin mars 2027. **(Vendim nr. 100, datë 02.09.026)**

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Tiranë, më 2 shtator 2026